




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik/Municipality of Kačanik
Zyra e Kryetarit



Me datë 10.12.2019
01.Nr. 104/02-39005/19

Në mbështetje të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 43.3 pika (c) të Ligjit nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221 dhe Ligjit nr.04/L-116, të Rregullorës MF – nr.02/2013 – Për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore dhe nenit 73 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës mori këtë:

V E N D I M
PËR EMËRIMIN E KOMISIONIT TË PËRGJITHSHËM PËR VLERËSIMIN DHE
HARMONIZIMIN E RAPORTEVE TË PASURISË JO FINANCIARE –
INEVENTARIZIMIN E PASURISË JOKAPITALE

1. Me këtë Vendim, emërohet komisioni i përgjithshëm për vlerësimin dhe harmonizimin e raporteve të pasurisë jo financiare – inventarizimin e pasurisë jokapitale.
2. Komisioni sipas pikës 1. të këtij Vendimi do të jetë në përbërje prej tre(3) anëtarëve dhe atë:
 - a. Ramiz Shehu, kryesues;
 - b. Ekrem Topalli, anëtar
 - c. Shyhrete Shehu, anëtare.
3. Në punën e tyre anëtarët e komisionit sipas pikës 2 të këtij vendimi, duhet të aplikojnë të gjitha procedurat standarde, ashtu siç kërkohen me dispozitat ligjore të cilat e rregullojnë këtë proces.
4. Obligohet komisioni që t'i ofroj Kryetarit të Komunës raportin e përgjithshëm të harmonizuar nga komisionet Arsimit, Shëndetësisë dhe Administratës komunale Raportin dhe Regjistrin e kompletuar me shkrim të nënshkruar dhe kopjen në formë elektronike, më së largu deri më datën 31.12.2019.
5. Në raportin përfundimtar komisioni duhet që në regjistrin e posaçëm t'i evidentoj mobiljet dhe pajisjet e dalura jashtë përdorimit (të dëmtuara, të vjetërsuara, jo funksionale dhe që kanë arritur periudhën e zhvlerësimit) duke u bazuar në raportet e komisioneve për inventarizim.
6. Raporti përfundimtar duhet t'i dërgohet zyrtarit të e-pasurisë me ndryshimet dhe rekomandimet e paraqitura dhe zyrtari i e-pasurisë obligohet që të bëjë ndryshimet në sistem.
7. Komisioni duhet të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij.

Me këtë Vendim njoftohen:


1. Anëtarët e komisionit;
2. DEFZH
3. Arkivi



z. Besim Ilazi
Kryetari i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Kryetari i Komunës
01-08Nr. 302/01-38247/19
Kaçanik, 09.12.2019

Kryetari i Komunës duke u bazuar në nenin 58 të Ligjit Nr.03/L-040, Për Vetqeverisje Lokale, vendimit të Kuvendit Komunal 01-08Nr.322-39890/18 të datës 27.12.2018, Rregulloren Komunale 2007/30 merr këtë:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL PËR VERIFIKIMIN DHE NDARJEN E
MASËS DRUSORE QË GJENDEN NË PARKUN E INVALIDËVE TË LUFTËS

I

Me këtë vendim formohet komisioni komunal për verifikimin e masës drusore që gjenden në autoparkun e invalidëve të luftës së UÇK-së me këtë përbërje:

1. Agim Luzha – Zyrtar i sektorit të Pylltarisë
2. Mustafë Loku- Zyrtar Bujqësi dhe Blegtori
3. Remzi Dema– Anëtar i shoqatës së invalidëve të luftës

II

Komisioni i formuar është i obliguar që të bëjë verifikimin e masës drusore të konfiskuar në bazë fletkonfiskimeve të pranuar nga SH.I.L. dhe të bëjë në mes të SH.I.L. dhe Komunës sipas marëveshjes

III

Pas verifikimit dhe ndarjes së masës drusore komisioni është i obliguar të raportoj me shkrim lidhur me sasinë e masës drusore që gjenden në depon e shoqatës me të cilin do të njoftoj: Kryetarin e Komunës, dhe DBZHRP-së.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e marrjes.

V

Me këtë Vendim njoftohen : Arkivi I Komunës, DBZHRP-së dhe anëtarët e komisionit.

Kryetari i Komunës

Besim Hazi





03.12.2019

01.Nr. 104/128258/19

Në mbështetje të nenit 13 dhe 17 të Ligjit Nr.03/L-40- për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 87 të Ligjit Nr. 04/042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E EKIPIT SHQYRTUES PËR SHITJE TË ASETEVE/VETURAVE

1. Me këtë Vendim formohet ekipi shqyrtues për shitjen e aseteve-veturave me këtë përbërje:

- a. Besnik Bajra
- b. Ibush Lika
- c. Rufki Zharku

2. Detyrat e anëtarëve si në pikën 1 të këtij vendimi janë që të konstatoj dobishmërinë e tyre, të përcaktoj vlerën e tregut të aseteve si dhe të propozoj mënyrën e shitjes.

Me këtë Vendim njoftohen:

Ibush Lika

Besnik Bajra

Rufki Zharku

Kryetari i Komunës

Dr. Z. Besim Ilazi

